

3. Grupi ndërinstitucional i punës ka për detyrë që, përmes angazhimit të ekspertëve vlerësues të licencuar në fushën përkatëse, të bëjë përlllogaritjen e drejtë të dëmit të pësuar nga viktimat në përputhje me praktikat më të mira kombëtare, si dhe të gjejë burimet për përballimin e efekteve financiare e të propozojë mënyrën më të përshtatshme për përballimin e këtyre shpenzimeve.
4. Grupi ndërinstitucional i punës, për aq sa është e mundur, të përzgjedhë ekspertët vlerësues edhe me pëlqimin e familjarëve të viktimave.
5. Grupi i punës të përgatitë një raport të hollësishëm për veprimtarinë e vet, të cilin së bashku me aktekspertimet e ekspertëve vlerësues t'ia paraqesë ministrit të Punëve të Brendshme brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
6. Ministri i Brendshëm, në bazë të raportit të grupit të punës dhe aktit të ekspertëve, harton dhe propozon projektvendimin për shpërblimin e drejtë të dëmit të pësuar nga viktimat në ngjarjen e 11 janarit të vitit 2011, si pasojë e veprimeve të Gardës së Republikës, të cilin ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.
7. Ngarkohet Ministria e Brendshme për përballimin e honorareve të ekspertëve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrave të grupit ndërinstitucional të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

